| | | |
|---|---|---|
| | **Republika e Kosovës**<br>**Republika e Kosovës**<br>**Republika Kosova-Republic of Kosovo**<br>**Komuna e Shtimes-Municipality of Shtime** | |

**Shkolla e Mesme e Lartë Gjimnazi "Naim Frashëri" Shtime**

**Protokoll: 297/23** **Datë: 4 dhjetor 2023**

# FTESË PËR OFERTË

Me iniciativën e Këshillit të Prindërve dhe pas miratimit nga Këshilli Drejtues i shkollës ky i fundit bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI), nr. 03/2016, Neni 9, paragrafi 11, mori vendim në mbledhjen e mbajtu më 22 qershor 2023 për Kodin etik të veshjes në shkollë.

Arsyetim – që identifikimi dhe menaxhimi të jetë më i suksesshëm në shkollë në aspektin e sigurisë së nxënësve tanë duke synuar edhe parimin e barazisë së nxënësve, parimeve morale dhe njerëzore.

Bazuar në këtë vendim Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtimet fton të gjitha kompanitë e tekstilit të interesuara që të dorëzojnë ofertat e tyre për:

***<u>Furnizim me uniforma shkollore për nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin Teknik të shkollës sonë.</u>***

**Kërkesat e aprovuara nga Këshilli Drejtues janë:**

1. Triko me mëngë të shkurta (maica) me jakë rrethore;
2. Triko me mëngë të shkurta dhe me jakë polo;
3. Duks me mëngë të gjata ose xhaketë (me pulla ose zingjirë);
4. Pantollona të përshtatshme për moshat e nxënësve;
5. Uniforma për ceremonin e diplomimit te klasat e 12 -ta (pelerinë dhe kapele);

- Për ngjyrën negociohet pasi të vendoset ofertuesi;
- Kualiteti i materialit të jetë i garantuar për së paku 1 vit;
- Blerësi mban të drejtën e kthimit (reklamimit) të produktit brenda 48 orëve dhe ajo duhet të ndërrohet nga furnitori;

- Kontrata do të jetë një vjeçare me mundësi vazhdimi sipas performanceës së shërbimit nga furnitori;
- Të gjitha produktet duhet të kenë kualitetin e lartë që të mos dëmtohen nga pastrimi, të jenë të qëndrueshme dhe me material pambuku 80%;
- Të gjitha produktet të kenë llogon e shkollës tonë me qepje;
- Në kuadër të ofertës na dërgoni edhe sasinë falas në nivel shkolle për rastet sociale dhe nxënës nga kategoritë tjera, propozimet finale caktohen pas përzgjedhjes së kompanisë;
- Numri total i nxënësve në shkollën tonë është 530 nxënës, 47 mësimdhënës dhe 5 punëtorë teknik;

Të interesuarit duhet të kenë këto dokumente dhe ti sjellin bashkë me ofertë:

- Certifikatën e biznesit
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Vërtetim tatimor (me numër fiskal)
- Kopje e letërnjoftimit (ID-së) të ofertuesit;
- Kopjen gjirollogarisë bankare (pas përzgjedhjes së ofertuesit);
- Deklaratë nën betim për kualitetin e materialeve dhe furnizmin me kohë;
- Certifikatën nga gjykata;

**Vërejtje**:

Konkursi mbetet i hapur shtatë (7) ditë kalendarike prej datës së publikimit të ftesës për ofertim. Operatorët e interesuar ekonomik duhet ti dorëzojnë ofertat e tyre në pliko të mbyllura dhe të vulosura te pjesa e hapjes. Gjjithashtu ti sjellin edhe mostrat me vete në drejtori. Ofertat do të pranohen dhe hapen nga Komisioni në prani të ofertuesve nga ora 13:00 më date 11. 12. 2023.

Komisioni me pjesëmarrës nga Këshilli Drejtues, Këshilli i Prindërve, Këshilli i nxënësve dhe menaxhmenti i shkollës do të vendosin për ofertën më cilësore dhe më të volitshme për prindër më date 11. 12. 2023.

Dorëzimi bëhet më datë 11 dhjetor 2023, nga ora 13:00 - 13:15 pranë komisionit në shkollë.

Për çdo paqartësi ose pyetje që keni rreth kësaj çështje mund të kontaktoni përmes postës elektronike shml.naim.frasheri@rks-gov.net .

Oferta do të vendoset në hyrje të shkollës si dhe në faqen e facebook-ut të shkollës dhe në atë të komunës.

| | |
|---|---|
| Këshilli Drejtues i Shkollës | Drejtori |
| R. MUJOTA | Zejnepe HYSENAJ |